

GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS
DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE
lidhur me rastin **EK.nr. 316/20**

Paditës: **Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së («Sindikata»)**
Lagjja Dardania p.n., 10010 Prishtinë
përfaqësuar nga juristët Getoar Mjeku dhe Blerim Sallahu

i paditur: **DARDAFON.net L.L.C. («Z Mobile»)**
Rr. Dëshmori p.n., Miradi e Epërme, 12510 Fushë-Kosovë

e interesuar: **Telekomi i Kosovës, SH.A. («Telekomi»)**
Lagjja Dardania p.n., 10010 Prishtinë

E hënë, 20 korrik 2020

URGJENCË — KËRKESË PËR MASË TË PËRKOHSHME

Paditëse-propozuesja ka dorëzuar padi dhe kërkesë për masa të sigurimit, më 17 korrik 2020. Paditësja tani lut Gjykatën e nderuar që kërkesën ta shqyrtojë me urgjencë si propozim për masë të përkohshme, dhe në përputhje me nenin 306.1 të Ligjit për procedurën kontestimore, të vendosë masa sigurie menjëherë, pa e njoftuar dhe dëgjuar kundërshtarin.

Marrë parasysh rrezikun që ndërmarrja Telekomi i Kosovës të falimentojë brenda këtij muaji, mundësinë që institucionet shtetërore të mbeten pa shërbime të internetit dhe telefonit, si dhe arsyet e cekura në paragrafët 206–209 të padisë, një masë siguroese e vonuar do të humbte qëllimin e saj.

Arsyet e hollësishme për masat dhe kërkesën e saktë i kemi shtjelluar në pjesën VII të padisë.

Me respekt,

Dr. Getoar Mjeku, jur.
përfaqësues i paditëses

Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com